

## **Përfshirjet nga taksa e ndërtesës sipas projektligjit të ri**

Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore
- Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara
- Banesat sociale në pronësi të bashkive
- Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre
- Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”
- Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike
- Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohej mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, vetëm kur përdoren për qëllime jofitimprurëse